



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Zyra e Rregullatorit për Energji

**Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike
(Rregulla për Çmimet e FPÉE-së)**

2011



PËRMBAJTJA

KREU I	Kushtet e përgjithshme	3
Neni 1	Qëllimi dhe fushëveprimi	3
Neni 2	Përkufizimet dhe interpretimet	3
KREU II	Tarifa e rregulluar me pakicë	7
Neni 3	Parimet e përgjithshme	7
Neni 4	Shqyrtimet e vlerave hyrëse	7
Neni 5	Azhurnimet vjetore	8
Neni 6	Shqyrtimet e jashtëzakonshme	8
KREU III	Vlerat hyrëse	10
Neni 7	Definicioni i vlerave hyrëse	10
Neni 8	Specifikimi i vlerave hyrëse	10
KREU IV	Të hyrat e lejuara maksimale	11
Neni 9	Parimet e përgjithshme	11
Neni 10	Kostot e lejuara me pakicë	12
Neni 11	Kostot e lejuara të kapitalit punues	13
Neni 12	Kostot e lejuara të borxhit të keq	13
Neni 13	Kostot e lejuara të energjisë me shumicë	13
Neni 14	Kostot që barten	16
Neni 15	Alokimi i kostove	16
KREU V	Metodologjia për strukturën tarifore	18
Neni 16	Metodologjia për strukturimin e tarifës së rregulluar me pakicë	18
KREU VI	Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare	19
Neni 17	Gjuha zyrtare	19
Neni 18	Ndryshimi	19
Neni 19	Interpretimi	19
Neni 20	Shfuqizimi	19
Neni 21	Hyrja në fuqi	19
Shtojca 1	Llogaritja e të hyrave të lejuara maksimale	20
Shtojca 2	Baza e aseteve të rregulluara	23
Shtojca 3	Procesi i shqyrtimit të vlerave hyrëse	26
Shtojca 4	Procesi i azhurnimeve vjetore	29
Shtojca 5	Procesi i shqyrtimit të jashtëzakonshëm	31
Shtojca 6	Ngjarjet e jashtëzakonshme	33
Shtojca 7	Ngjarja e forcës madhore	33
Shtojca 8	Periudha kalimtare	35



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.16, Nenin 25 dhe Nenin 42, paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, në seancën e mbajtur me 30.09.2011, miratoi:

Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së)

KREU I KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1 Kjo rregull përcakton:
 - 1.1 Metodologjinë për vendosjen e tarifës së rregulluar me pakicë që ngarkohet nga furnizuesi publik i energjisë elektrike (“FPEE”) për furnizimin me pakicë të energjisë elektrike; dhe
 - 1.2 Procesin për shqyrtimin dhe përshtatjen e tarifës së rregulluar me pakicë.
- 2 Kjo rregull vlen për të gjithë konsumatorët, të cilët ngarkohen me tarifë të rregulluar të energjisë elektrike (“Konsumatorë të rregulluar”). Në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, konsumatorët e rregulluar janë:
 - 2.1 Të gjithë konsumatorët e pakualifikuar; dhe
 - 2.2 Konsumatorët e kualifikuar, në rastin kur rregullatori nuk është i kënaqur me nivelin e zhvillimit të konkurrencës efektive në furnizim.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:
 - 1.1 “Të hyra të rregulluara aktuale” nënkupton të hyrat që mbulohen nga FPEE-ja, duke ua ngarkuar tarifën e rregulluar me pakicë konsumatorëve të rregulluar, matur në baza të rrjedhës aktuale;



- 1.2 "Azhurnim vjetor" nënkupton përshtatjet e të hyrave të lejuara dhe tarifës së rregulluar me pakicë, të realizuar në fund të çdo viti relevant;
- 1.3 "Borxhi i keq i lejuar" e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 12, paragrafi 1;
- 1.4 "Ditë pune" quhen të gjitha ditët e punës brenda një jave, të përcaktuara sipas ligjeve në Kosovë;
- 1.5 "Kategori e konsumatorëve" nënkupton klasifikimin e llojeve të ndryshme të konsumatorëve për qëllime të ngarkimit me tarifën me pakicë. Klasifikimi duhet të ketë parasysh mënyrën e matjes së energjisë aktive dhe kapacitetit, mënyrën e konsumit të energjisë elektrike, ngarkesën e pikut, tensionin e furnizimit dhe karakteristikat e tjera që kanë ndikim në koston e furnizimit;
- 1.6 "Operatori i sistemit të shpërndarjes" apo "OSSH" nënkupton bartësin e licencës për operator të sistemit të shpërndarjes;
- 1.7 "Ngarkesa për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes" apo "Ngarkesa DUOS" nënkupton ngarkesën e rregulluar të ngarkuar nga OSSH për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- 1.8 "Jetëgjatësia ekonomike" nënkupton jetëgjatësinë e përdorur për llogaritjen e zhvlerësimit të lejuar në Bazën e aseteve të rregulluara;
- 1.9 "Faktori ndarës i eksportit" e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 13, paragrafi 10;
- 1.10 "EURIBOR" nënkupton normën e ofrimit për depozita të euros nga Federata bankare evropiane për periudhë 3-mujore, që paraqitet në faqen e caktuar të shërbimit të "Reuters" në ora 11:00 (kohë e matur sipas kohës qendrore evropiane) ose, në rast se "Reuters" nuk vazhdon ta ofrojë këtë informacion, cilido shërbim tjetër për të cilin pajtohen OSSH dhe Rregullatori. Për të shmangur dyshimin kjo do të jetë normë vjetore;
- 1.11 "Gjoha për eksport" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 13, paragrafi 15;
- 1.12 "Përshtatje e jashtëzakonshme" ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5;
- 1.13 "Ngjarje e jashtëzakonshme" ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
- 1.14 "Shqyrtim i jashtëzakonshëm" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 6;
- 1.15 "Vendim final" ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3, paragrafi 9;
- 1.16 "Ngjarjet e forcës madhore" e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 7;
- 1.17 "Vlerat hyrëse" e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7;



- 1.18 “Shqyrtimi i vlerave hyrëse” nënkupton shqyrtimin nga rregullatori për të përcaktuar vlerat hyrëse;
- 1.19 “Taksa për licencë” nënkupton shumën për pagesë sipas Nenit 7 të pasqyrës së taksave, që lëshohet nga rregullatori dhe mund të amendamentohet;
- 1.20 “Operator i tregut” apo “OT” nënkupton bartësin e licencës për operator të tregut;
- 1.21 “Ngarkesat e operatorit të tregut” apo “Ngarkesat OT” nënkupton serinë e rregulluar të ngarkesave që aplikohen nga OT-ja për ofrimin e shërbimeve të operatorit të tregut.
- 1.22 “Pragu i materialitetit” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5;
- 1.23 “Të hyrat e lejuara maksimale” (Maximum Allowed Revenues) ose “MAR” nënkuptojnë të hyrat maksimale që mund të mbulohen brenda një viti relevant nga FPEE përmes tarifës së rregulluar me pakicë, të cilat rregullohen sipas formulave të Shtojcës 1 të kësaj rregulle;
- 1.24 “Vlera neto e tanishme” nënkupton shumën e zhvlerësimit të rrjedhave të ardhshme të parasë;
- 1.25 “Kostot që barten” nënkupton kostot e përcaktuara në pajtim me Nenin 14;
- 1.26 “Propozim” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3, paragrafi 4;
- 1.27 “Vlerësim i përkohshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3, paragrafi 7;
- 1.28 “Furnizuesi publik i energjisë elektrike” apo “FPEE” nënkupton bartësin e licencës për furnizim publik;
- 1.29 “Konsumator i rregulluar” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 3, paragrafi 1;
- 1.30 “Tarifë e rregulluar me pakicë” nënkupton bashkësinë e çmimeve që FPEE ua ngarkon konsumatorëve të rregulluar për ofrimin e shërbimeve standarde, siç përcaktohen nga rregullatori;
- 1.31 “Rregullatori” nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji;
- 1.32 “Bazë e aseteve të rregulluara” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 2;
- 1.33 “Vit relevant” nënkupton periudhën prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm në mes të azhurnimeve vjetore;
- 1.34 “Marzha me pakicë” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 13;



- 1.35 “Shërbime standarde” nënkupton shërbimet që u ofrohen konsumatorëve për furnizimin me energji elektrike nga FPEE, siç përkufizohen në Licencën për furnizim publik dhe kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
 - 1.36 “Raport i ndikimit financiar” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5;
 - 1.37 “Ngarkesat e operatorit të sistemit” apo “Ngarkesat OS” nënkuptojnë ngarkesat e aplikuara nga OST për kryerjen e shërbimeve të operatorit të sistemit;
 - 1.38 “Periudhë kalimtare” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
 - 1.39 “Ngarkesë për shfrytëzimin e rrjetit të sistemit të transmisionit” apo “Ngarkesë TNUOS” nënkupton ngarkesën e rregulluar që aplikohet nga OST për transmetimin e energjisë elektrike;
 - 1.40 “Operator i sistemit të transmisionit” apo “OST” nënkupton bartësin e Licencës së Operatorit të sistemit të transmisionit;
 - 1.41 “Konsumatorët e parregulluar” nënkupton çdo konsumator të FPEE-së që nuk është konsumator i rregulluar;
- 2 Termat e tjera të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Energjinë.



KREU II TARIFA E RREGULLUAR ME PAKICË

Neni 3

Parimet e përgjithshme

- 1 FPEE i ngarkon konsumatorët e rregulluar me tarifën e rregulluar me pakicë.
- 2 Tarifa e rregulluar me pakicë përcaktohet dhe aprovet gjatë çdo azhurnimi vjetor, ashtu që:
 - 2.1 Gjatë secilit vit relevant, të hyrat që FPEE parashikon të mbledhë nga tarifa e rregulluar me pakicë të jenë të barabarta me të hyrat e lejuara maksimale (Kreu IV); dhe
 - 2.2 Tarifa e rregulluar me pakicë të jetë në përputhje me metodologjinë e strukturës tarifore (Kreu V).
- 3 Të hyrat e lejuara maksimale përcaktohen si vijon:
 - 3.1 Të hyrat e lejuara maksimale përcaktohen në azhurnimet vjetore (Neni 5);
 - 3.2 Llogaritja e të hyrave të lejuara maksimale përdor vlerat hyrëse të caktuara gjatë Shqyrtimeve të vlerave hyrëse; dhe
 - 3.3 Shqyrtimet e jashtëzakonshme (neni 6), që përfshijnë përshtatjen e të hyrave të lejuara maksimale për ndryshimet materiale në kosto apo në të hyra e që shkaktohet nga një ngjarje e jashtëzakonshme, do të realizohen kur është e nevojshme.
- 4 Dispozitat kalimtare të dhëna në Shtojcën 8 do të aplikohen deri më 31 mars 2015.

Neni 4

Shqyrtimet e vlerave hyrëse

- 1 Vlerat hyrëse të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të FPEE-së do të caktohen gjatë shqyrtimeve të vlerave hyrëse. Ndryshimet në vlerat hyrëse duhet të bëhen vetëm në atë masë që këto ndryshime të jenë të arsyeshme, të justifikuar dhe të caktuara me kujdes.
- 2 Shqyrtimet e vlerave hyrëse do të iniciohen nga rregullatori kurdo që rrethanat e ndryshuara kërkojnë iniciimin e një shqyrtimi të tillë.
- 3 FPEE mund t'i propozojë rregullatorit fillimin e shqyrtimit të vlerave hyrëse. Rregullatori do t'i përgjigjet kërkesës së tillë me një shkresë që paraqet arsyetimet për vendimin e ZRRE-së për të filluar apo për të mos filluar shqyrtimin.



- 4 Procedura për mbarëvajtjen e shqyrtimeve të vlerave hyrëse është dhënë në Shtojcën 3.

Neni 5

Azhurnimet vjetore

- 1 Gjatë azhurnimeve vjetore llogaritet ndryshimi i lejuar në të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifa rezultuese e rregulluar me pakicë përcaktohet sipas rrethanave.
- 2 Azhurnimet vjetore do të bëhen para çdo viti relevant.
- 3 Ndryshimi në të hyrat e lejuara maksimale në secilin azhurnim vjetor do të bazohet në:
 - 3.1 Parashikime të azhurnuara të kostove të lejuara;
 - 3.2 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e të hyrave të lejuara maksimale në vitin relevant për shkak të ndryshimeve në mes të faturimit të parashikuar dhe të realizuar të energjisë elektrike;
 - 3.3 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e kostove me shumicë dhe kostove që barten për shkak të ndryshimeve në mes të kostove të parashikuara dhe atyre të realizuara, me mundësi të ndarjes së kostove të pabalancuara dhe të ardhurave nga eksporti në mes të FPEE-së dhe konsumatorit të rregulluar.
- 4 Formulatat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale gjatë azhurnimeve vjetore janë dhënë në Shtojcën 1.
- 5 Procesi për realizimin e azhurnimeve vjetore është dhënë në Shtojcën 4.

Neni 6

Shqyrtimet e jashtëzakonshme

- 1 Shqyrtimet e jashtëzakonshme mund të shkaktohen nga ngjarjet e jashtëzakonshme, siç përkufizohen në Shtojcën 6.
- 2 Gjatë shqyrtimeve të jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale për pjesën e mbetur të periudhës rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë do të bëhet përshtatja e jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale. Pragu i materialitetit do të jetë 5% e të hyrave, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshje të përbashkët në mes të FPEE-së dhe rregullatorit.
- 3 Llogaritja e ndikimit mbi të hyrat e lejuara maksimale dhe përshtatja e jashtëzakonshme e ndërlydhur nuk duhet të marrë parasysh faktorët të cilët nuk ndikohen në mënyrë direkte nga ngjarja e jashtëzakonshme.



- 4 Rregullatori do të marrë parasysh ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë pragun e materialitetit) në azhurnimet vjetore të ardhshme.
- 5 Procesi për realizimin e shqyrtimeve të jashtëzakonshme jepet në Shtojcën 5.



KREU III VLERAT HYRËSE

Neni 7

Definicioni i vlerave hyrëse

- 1 Vlerat hyrëse janë parametrat kryesorë të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të FPEE-së.
- 2 Vlerat hyrëse përbëhen nga:
 - 2.1 Jetëgjatësia ekonomike e aseteve;
 - 2.2 Marzha me pakicë;
 - 2.3 Niveli i lejuar për borxhet e këqija;
 - 2.4 Faktori ndarës balancues; dhe
 - 2.5 Faktori ndarës i eksportit.

Neni 8

Specifikimi i vlerave hyrëse

- 1 Vlerat pasuese specifikohen si vlera fikse, të cilat do të aplikohen gjatë viteve relevante deri në shqyrtimin e vlerave hyrëse:
 - 1.1 Jetëgjatësia ekonomike e aseteve;
- 2 Vlerat pasuese mund të specifikohen si fikse apo si tabelë vlerash me ç'rast do të aplikohet vlerë e ndryshme për çdo vit relevant nga viti i tanishëm relevant deri në shqyrtimin e ardhshëm të vlerave hyrëse:
 - 2.1 Marzha me pakicë;
 - 2.2 Niveli i lejuar për borxhet e këqija;
 - 2.3 Faktori ndarës i debalancit; dhe
 - 2.4 Faktori ndarës i eksportit.



KREU IV TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE

Neni 9

Parimet e përgjithshme

- 1 Të hyrat e lejuara maksimale do të jenë të barabarta me kostot e arsyeshme të FPEE-së për ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar, dhe me kusht që këto kosto të jenë të arsyeshme dhe të matura saktësisht.
- 2 Kostot e arsyeshme të FPEE-së do të përfshijnë:
 - 2.1 Kostot e lejuara me pakicë (Neni 10);
 - 2.2 Kostot e lejuara të kapitalit punues (Neni 11);
 - 2.3 Kostot e lejuara të borxhit të keq (Neni 12);
 - 2.4 Kostot e lejuara të energjisë elektrike me shumicë (Neni 13), duke përfshirë marzhën me pakicë, të cilat duhet të barten bazuar në faktorin ndarës të debalancit dhe faktorin ndarës të eksportit gjatë azhurnimeve vjetore;
 - 2.5 Kostot e bartura të cilat përfshijnë ngarkesat e OT-së, OS së, TNUOS, DUOS dhe taksat për licenca, të cilat barten plotësisht, gjatë azhurnimeve vjetore.
- 3 Gjatë përcaktimit të kostove të lejuara, rregulatori do t'u referohet, por nuk kufizohet apo limitohet në:
 - 3.1 Informatat ekzistuese të periudhave të kaluara për vëllimin, koston dhe kualitetin e shërbimeve të FPEE-së;
 - 3.2 Parashikimin rreth vëllimit, kostove dhe kualitetit të shërbimeve të FPEE-së;
 - 3.3 Krahasimet me ndërmarrje të ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës; dhe
 - 3.4 Krahasimet me kostot e aktiviteteve të ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës.
- 4 Kostot rezultuese të arsyeshme do t'u alokohen konsumatorëve të rregulluar siç parasheh Neni 15.



- 5 Çdo e hyrë tjetër, që nuk është mbledhur nga tarifat, por që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar, do të zbritet nga të hyrat e lejuara maksimale, duke përfshirë çfarëdo ndryshimi në mes të vlerës së shitjeve të aseteve dhe vlerës së tyre rregullative.

Neni 10

Kostot e lejuara me pakicë

- 1 Kostot e lejuara me pakicë përfshijnë këto kosto të lejuara që kanë të bëjnë me furnizimin e Konsumatorëve të rregulluar:
- 1.1 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes;
 - 1.2 Kostot e korporatës;
 - 1.3 Kostot e zhvlerësimit; dhe
 - 1.4 Çdo kosto tjetër me të cilën në mënyrë të arsyeshme është ballafaquar FPEE-ja gjatë ofrimit të shërbimeve me pakicë për konsumatorët e rregulluar.
- 2 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes nuk do të përfshijnë:
- 2.1 Kostot e reklamimit dhe formave të tjera të marketingut që kanë për qëllim inkurajimin e konsumit, për arsye se FPEE-ja nuk konkurren për konsumatorët e rregulluar; dhe
 - 2.2 Tatimet apo detyrimet që synohet të mblidhen përmes marzhës me pakicë.
- 3 Kostot e lejuara të korporatës përfshijnë kostot (ose një pjesë të kostos totale të korporatës nëse FPEE-ja është kompani vartëse apo kompani degë e ndonjë entiteti tjetër) që janë të nevojshme dhe i atribuohen funksionimit të rregullt të FPEE-së por që, duke përdorur praktika normale dhe të zakonshme të kontabilitetit, nuk lidhen drejtpërsëdrejti me ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar.
- 4 Komunikimet publike për informata rreth sigurisë, konservimit, inkurajimit të pagesave të rregullta dhe dekurajimit të shfrytëzimit të paautorizuar janë kosto të lejueshme; dhe
- 5 Kostot e lejuara të zhvlerësimit do të llogariten në bazë të metodës lineare si funksion i bazës së aseteve të rregulluara dhe jetëgjatësisë ekonomike të aseteve, siç përshkruhet në Shtojcën 2.



Neni 11

Kostot e lejuara të kapitalit punues

- 1 Kostot e kapitalit punues do të llogariten si kostoja e financimit të kapitalit punues për FPEE-në, shumëzuar me vlerën e lejuar të kapitalit punues.
- 2 Kostoja e financimit të kapitalit punues do të llogaritet si EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike dhe reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra.
- 3 Vlera e lejuar e kapitalit punues do të llogaritet si 1/12-ta e shumës së kostove të lejuara me pakicë, kostot e lejuara të energjisë me shumicë, kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë dhe kostot që barten.

Neni 12

Kostot e lejuara të borxhit të keq

- 1 Kostot e lejuara të borxhit të keq do të llogariten duke aplikuar nivelin e lejuar të borxhit të keq sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.
- 2 Niveli i lejuar i borxhit të keq do të jetë një vlerësim i përafërt i nivelit të arsyeshëm të borxheve të këqija që mund ta ketë FPEE-ja.

Neni 13

Kostot e lejuara të energjisë me shumicë

- 1 Kostot e lejuara të shitjes së energjisë me shumicë duhet të përmbajnë:
 - 1.1 Kostot e lejuara me shumicë të kapacitetit;
 - 1.2 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë; dhe
 - 1.3 Marzha me pakicë në kostot e lejuara me shumicë të kapacitetit dhe kostot e energjisë me shumicë.
- 2 Të hyrat e lejuara maksimale duhet të përshtaten për të marrë parasysh ndryshimet në kostot e lejuara me shumicë të energjisë në secilin azhurnim vjetor sipas formulës së dhënë në Shtojcën 1.
- 3 Kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë janë ato kosto të ndërlidhura me pagesën e ngarkesave të kapacitetit për kapacitet gjenerues vendor, i cili kontraktohet për qëllime të garantimit të sigurisë së furnizimit dhe ka të bëjë me furnizimin e konsumatorëve të rregulluar.



- 4 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë që kanë të bëjnë me shërbimin për konsumatorët e rregulluar përfshijnë:
 - 4.1 Kostot e blerjes së energjisë nga gjenerimi vendor;
 - 4.2 Kostot e importit të energjisë;
 - 4.3 Të hyrat e eksportit të energjisë (si kosto negative), që i nënshtrohen faktorit ndarës të eksportit;
 - 4.4 Kostot neto të debalancit, që i nënshtrohen faktorit ndarës të debalancit.
- 5 Të hyrat që kanë të bëjnë me shitjen e energjisë OST-së dhe OSSH-së për të mbuluar humbjet në transmision dhe në shpërndarje do të zbriten nga kostoja e lejuar e energjisë me shumicë, për të shmangur kthimin e koston së humbjeve të energjisë dy herë.
- 6 Kostot e lejuara të blerjeve të energjisë nga gjenerimi vendor përfshijnë koston e realizuar të FPEE-së për blerjen e energjisë nga gjeneratorët në Kosovë (si të rregulluar, ashtu edhe të parregulluar) për të furnizuar konsumatorët e rregulluar, siç përcaktohet në marrëveshjet për blerjen e energjisë apo në formë tjetër, minus kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë.
- 7 Kostot e lejuara të blerjeve të energjisë nga gjenerimi vendor i energjisë nuk do të përfshijnë kostot shtesë të gjenerimit që mbulohen nga mekanizmat e veçantë, siç është për shembull ndryshimi në mes të nivelit të tarifës Feed-in dhe koston mesatare të energjisë me shumicë, që përdoret për blerje të energjisë nga gjeneratorët e burimeve të ripërtëritshme.
- 8 Kostoja e lejuar e blerjes së energjisë nga importi do të jetë kostoja e realizuar nga FPEE-ja për blerjen e energjisë nga importi, e përcaktuar nga kontratat e importit, minus subvencionet për import të dhëna nga Qeveria e Kosovës.
- 9 Të hyrat e lejuara të eksportit të energjisë do të jenë të hyrat e realizuara që FPEE i fiton me anë të shitjes së energjisë së eksportuar.
- 10 Faktori ndarës i eksportit duhet të jetë një përqindje fikse që aplikohet në të hyrat e eksportit për të përcaktuar ndarjen e këtyre të hyrave në mes të FPEE-së dhe konsumatorëve të rregulluar. Faktori ndarës i eksportit duhet të jetë i mjaftueshëm për të inkurajuar FPEE-në që të maksimizojë të hyrat e eksportit, por të mos rezultojë në përfitime të tepruara për FPEE-në.
- 11 Kostot e lejuara neto të debalancit do të përfshijnë kostot e realizuara minus të hyrat e fituara (siç përcaktohen në pajtueshmëri me rregullat e tregut) që rezultojnë nga debalancet në mes të kërkesës së realizuar nga konsumatorët e rregulluar dhe furnizimi i kontraktuar me energji.
- 12 Faktori ndarës i debalancit duhet të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot neto të debalancit për të përcaktuar ndarjen e këtyre shpenzimeve në mes të FPEE-së dhe Konsumatorëve të rregulluar, ku vlera prej 0% nënkupton që të gjitha kostot neto të debalancit i alokohen FPEE-së, ndërsa vlera prej 100% nënkupton që të gjitha kostot neto të debalancit u alokohen konsumatorëve. Gjatë përcaktimit të Faktorit ndarës të debalancit, rregullatori duhet



të marrë parasysh se deri në ç'masë është në gjendje FPEE-ja që të menaxhojë debalancet dhe, në veçanti, balancin në mes të furnizimeve nga prodhimi vendor dhe importet e qëndrueshme si dhe kërkesës së përmbushur nga FPEE-ja. Rregullatori duhet ta caktojë faktorin ndarës të debalancit në 100% deri në momentin kur konsideron se furnizimi është në përgjithësi adekuat për të plotësuar kërkesat.

- 13 Të hyrat e lejuara që kanë të bëjnë me humbjet e energjisë në transmision apo në shpërndarje përbëhen nga vlera e realizuar e faturës që lëshohet nga FPEE-ja për OSSH-në dhe OST-në (siç përcaktohet në rregullat e tregut) për të kompensuar për ndryshimin në mes të energjisë së matur të dërguar nga gjeneratorët apo të importuar dhe energjisë së shpërndarë deri te konsumatorët e kualifikuar dhe të pakualifikuar.
- 14 Parashikimet e kostove të lejuara me shumicë të energjisë gjatë azhurnimeve vjetore do të marrin parasysh:
 - 14.1 Ndryshimet e reja dhe ato historike të çmimit të importit, eksportit, kostos së gjenerimit vendor, si dhe të hyrat që kanë të bëjnë me humbjet në transmision dhe në shpërndarje;
 - 14.2 Ndryshimet sezonale në çmimet e eksportit dhe të importit;
 - 14.3 Çmimet e kontratave përkatëse për shkëmbim të energjisë; dhe
 - 14.4 Faktorët e tjerë që ofrojnë mekanizma të besueshëm për parashikimin e kostos së energjisë me shumicë.
- 15 Rregullatori, bazuar në vlerësimin e tij, mundet të sjellë në përdorim një gjobë eksporti, e cila zbritet nga të hyrat e lejuara maksimale. Kjo gjobë do të aplikohet nëse FPEE-ja eksporton energji dhe nuk mbulon kërkesën e brendshme për energji, për shkak të gjenerimit apo importeve joadequate, siç është evidentuar në të dhënat e barazimeve të përgatitura nga OST. Gjopa për njësi do të ishte e mjaftueshme për të garantuar që FPEE-ja të ketë nxitje të fuqishme për t'i shërbyer kërkesës së brendshme para eksportimit, por nuk duhet të kërcënojë pozitën financiare të FPEE-së. Çdo gjobë e tillë duhet të sillet në përdorim vetëm nëse dhe në rastet kur rregullatori e konsideron se ka dëshmi se volume të konsiderueshme eksportesh janë duke u ndërmarrë nga FPEE-ja gjatë kohëve të reduktimeve të brendshme.
- 16 Marzha me pakicë do të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot e lejuara të energjisë me shumicë dhe kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë. Ajo duhet të caktohet në atë nivel që:
 - 16.1 T'i sigurojë FPEE-së përfitim të arsyeshëm që ta kompensojë për rreziqet që ndërmerr gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu referuar marzhave të fituara nga kompanitë e ngjashme në vende të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato vende dhe atë të Kosovës; dhe



- 16.2 T'i sigurojë FPEE-së kthim të arsyeshëm nga asetet fikse neto të saj të përdorura gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu referuar kostos së kapitalit të të licencuarve të tjerë në Kosovë.

Neni 14

Kostot që barten

- 1 FPEE-ja duhet t'i bartë të gjitha kostot që barten gjatë secilit azhurnim vjetor, i cili do të përfshijë:
 - 1.1 Kostot e OT-së që faturohen nga OT dhe kanë të bëjnë me konsumatorët e rregulluar;
 - 1.2 Kostot e OS-së që faturohen nga OST dhe kanë të bëjnë me konsumatorët e rregulluar;
 - 1.3 Kostot TNUOS që faturohen nga OST dhe kanë të bëjnë me konsumatorët e rregulluar;
 - 1.4 Kostot DUOS që faturohen nga OSSH dhe kanë të bëjnë me konsumatorët e rregulluar; dhe
 - 1.5 Pjesën e taksës së licencës që u përket konsumatorëve të rregulluar.

Neni 15

Alokimi i kostove

- 1 Për të përcaktuar kostot e lejuara që do të mbulohen nga konsumatorët e rregulluar dhe të hyrave të lejuara maksimale, kostot e arsyeshme të llogaritura sipas këtij kapitulli do të alokohen si më poshtë:
 - 1.1 Kostot e lejuara me pakicë dhe kostot e lejuara të kapitalit punues do të alokohen në proporcion me numrin e konsumatorëve. Për ta bërë këtë, kostoja mesatare për konsumator duhet të llogaritet duke pjesëtuar shumën e kostove totale me pakicë dhe kostove të kapitalit punues me numrin e përgjithshëm të konsumatorëve (të rregulluar dhe parregulluar). Kjo llogaritje do të ponderohet varësisht prej kostove të ndryshme të ofrimit të shërbimit me pakicë për grupet e ndryshme të konsumatorëve. Kjo kosto mesatare për konsumator do të shumëzohet me numrin e ponderuar të konsumatorëve të rregulluar për të përcaktuar kostot e lejuara me pakicë, dhe kostot e kapitalit punues që duhen të mbulohen prej konsumatorëve të rregulluar.
 - 1.2 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë dhe kostot e kapacitetit me shumicë do t'u alokohen konsumatorëve të rregulluar në një mënyrë që nuk e çorienton konkurrencën për konsumatorët e parregulluar. Dispozita të veçanta do të aplikohen gjatë periudhës kalimtare, siç është përcaktuar në Shtojcën 8.



- 1.3 Kostot që barten duhet t'u alokohen konsumatorëve të rregulluar në një mënyrë që ruan, aq sa është e mundur, sinjalin e çmimeve të ngarkesave.
- 1.4 Nuk është e nevojshme që t'u alokohen ndaras kostot e lejuara të borxhit të keq konsumatorëve të rregulluar, pasi që ky alokim rrjedh nga aplikimi i kostove të lejuara për borxhin e keq sipas formulave në Shtojcën 1.



KREU V METODOLOGJIA PËR STRUKTURËN TARIFORE

Neni 16

Metodologjia për strukturimin e tarifës së rregulluar me pakicë

- 1 Struktura e tarifës së rregulluar me pakicë do të jetë në përputhje me metodologjinë e caktuar në këtë nen dhe me udhëzimet e tjera që mund të nxirren nga Rregullatori.
- 2 Një bashkësi e vetme e çmimeve do të aplikohet për cilindo kategori të konsumatorëve.
- 3 Tarifa e rregulluar me pakicë nuk do të ketë ndër-subvencionim në mes të kategorive të konsumatorëve, përveç gjatë periudhës kalimtare të dhënë në Shtojcën 8.
- 4 Tarifa e rregulluar me pakicë do të marrë parasysh çështjet ambientale.
- 5 Bllok-tarifat mund të përdoren për të nxitur konsumin efikas të energjisë elektrike. Njëkohësisht, këto tarifa mund të përdoren për raste sociale kur rregullatori mbi bazë të dëshmive në dispozicion nuk është i kënaqur me nivelin e mbulueshmërisë së konsumatorëve në nevojë nga mekanizmat e tjerë subvencionues.
- 6 Tarifa e rregulluar me pakicë do të përfshijë tarifat ditë-natë për të nxitur konsumin efikas të energjisë elektrike në rastet kur ka matës adekuat për këtë qëllim dhe në rastet kur kjo justifikohet nga profili i ngarkesës.
- 7 Tarifa e rregulluar me pakicë do të ndryshojë për të reflektuar koston stinore të ofrimit të shërbimit, për të nxitur konsumin efikas të energjisë elektrike.
- 8 Tarifa e rregulluar me pakicë do të reflektojë koston e furnizimit të kategorive të ndryshme të konsumatorëve, në mënyrë që:
 - 8.1 Të ruajë me saktësi sinjalet e çmimeve të Ngarkesave të OT-së, OS-së, TNUOS, DUOS dhe taksës për licencë deri në masën e lejuar nga kufizimet për matjen e konsumatorëve;
 - 8.2 Të mbulojë kostot me pakicë dhe kostot e kapitalit punues që kanë të bëjnë me furnizimin e secilës kategori të ndryshme të konsumatorëve; dhe
 - 8.3 Të reflektojë koston e furnizimit të kategorive të ndryshme të konsumatorëve gjatë stinëve dhe kohëve të ndryshme brenda ditës deri në masën e lejuar nga kufizimet për matjen e konsumatorëve.



KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Gjuha zyrtare

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 18

Ndryshimi

1. ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 19

Interpretimi

Në rast paqartësie në lidhje me dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 20

Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon “Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve)” dhe “Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të aprovuara më 15 dhjetor 2005, si dhe amendamentimet e bëra më 29 nëntor 2006 në Metodologjinë e Tarifave, të nxjerra sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar



SHTOJCA 1 LLOGARITJA E TË HYRAVE TË LEJUARA MAKSIMALE

- 1 Kjo shtojcë paraqet formulat për llogaritjen e Të Hyrave të Lejuara Maksimale për FPEE-në. Kjo shtojcë plotëson parimet e dhëna në pjesën e parë të Rregullës.
- 2 Të hyrat e lejuara maksimale (MAR_t) do të llogariten në bazë të azhurnimeve vjetore me anë të kësaj formule:

$$MAR_t = (RETR_t + WCLC_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t + KREV_t) / (1 - BDTA_t)$$

Ku janë:

MAR_t Të hyrat e lejuara maksimale për vitin relevant t ("Maximum Allowed Revenues in Relevant Year t")

$RETR_t$ Kostot e lejuara me pakicë në vitin relevant t, të cilat caktohen gjatë azhurnimeve vjetore ("Retail costs in Relevant Year t, which is set at Annual Updates")

$WCLC_t$ Kostot e lejuara të kapitalit në vitin relevant t ("Working capital costs in Relevant Year t")

$WHPC_t$ Kostot e lejuara të energjisë me shumicë gjatë vitit relevant t ("Wholesale power costs in Relevant Year t")

$PSTC_t$ Kostot që bartet gjatë vitit relevant t ("Pass-Through Costs in Relevant Year t")

$NTFR_t$ Të hyrat jotarifore në vitin relevant t ("Non-tariff revenues in Relevant Year t")

$KREV_t$ Faktori korrektues i të ardhurave gjatë vitit relevant t ("Revenue correction factor in Relevant Year t")

$BDTA_t$ Kostot e lejuara për borxhin e keq gjatë vitit relevant t, që caktohen si vlerë përqindjeje (%) ("Bad Debt Allowance in Relevant Year t, set as a percentage (%) value")

- 2.1 Kostot e lejuara të kapitalit punues ($WCLC_t$) do të llogariten sipas formulës:

$$WCLC = (1 / 12) * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$$

Ku janë:

I_t paraqet normën e interesit në vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga rregullatori



gjatë azhurnimeve vjetore dhe që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huat afatshkurtra;

$RETR_t$	Kostot e lejuara me pakicë në vitin relevant t ("Allowed Retail Costs in Relevant Year t")
$WHPC_t$	Kostot e energjisë së përgjithshme me shumicë në vitin relevant t ("Allowed wholesale power costs in Relevant Year t")
$PSTC_t$	Kostot që barten në vitin relevant t ("Pass-Through Costs in Relevant Year t")
$NTRF_t$	Të hyrat jotarifore në vitin relevant t ("Non-tariff revenues in Relevant Year t")

2.2 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë ($WHPC_t$) do të llogariten duke përdorur formulën:

$$WHPC_t = (WHCC_t + WHEC_t) * (1 + RETM_t) + (WHPCa_{t-1} - WHPCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku janë:

$WHPC_t$	Kostoja e lejuar e energjisë me shumicë në vitin relevant t ("Allowed wholesale power costs in Relevant Year t")
$WHCC_t$	Kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë në vitin relevant t ("Allowed wholesale capacity costs in Relevant Year t")
$WHEC_t$	Kostoja e lejuar e energjisë me shumicë në vitin relevant t ("Allowed wholesale energy costs in Relevant Year t")
$RETM_t$	Marzha me pakicë në vitin relevant t (Retail Margin in Relevant Year t)
$WHPCa_{t-1}$	Kostot e lejuara të realizuara të energjisë me shumicë në vitin relevant t-1 ("is actual allowed wholesale power costs in Relevant Year t-1")
$WHPCf_{t-1}$	Kostoja e lejuar e parashikuar e energjisë me shumicë në vitin relevant t-1 ("Forecast allowed wholesale power costs as determined in Relevant Year t-1")
I_t	Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë azhurnimeve vjetore që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra

2.3 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë ($WHEC_t$) duhet të llogariten sipas formulës:



$$WHEC_t = GENC_t + IMPC_t - EXPR_t * EXPF_t + IMBC_t * IMBF_t$$

Ku janë:

$GENC_t$ Kostot e lejuara të blerjes së energjisë nga gjeneratorët vendorë në vitin relevant t (Allowed costs of purchases from domestic generation in Relevant Year t)

$IMPC_t$ Kostot e lejuara të energjisë së importit në vitin relevant t ("Allowed energy import costs in Relevant Year t")

$EXPR_t$ Të hyrat e lejuara nga eksporti i energjisë në vitin relevant t ("Allowed energy export revenues in Relevant Year t")

$EXPF_t$ Faktori ndarës i eksportit në vitin relevant t ("Export Sharing Factor in Relevant Year t")

$IMBC_t$ Kostot neto të imbalancit në vitin relevant t ("Allowed net imbalance costs in Relevant Year t")

$IMBF_t$ Faktori ndarës i imbalancit në vitin relevant t ("Imbalance Sharing Factor in Relevant Year t")

2.4 Faktori i përshtatjes së të hyrave ($KREV_t$) do të llogaritet duke përdorur formulën në vijim:

$$KREV_t = (MAR_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku janë:

$KREV_t$ Faktori i përshtatjes së të hyrave ("The revenue adjustment factor")

ARR_{t-1} Të hyrat aktuale të rregulluara gjatë vitit relevant t-1 ("Actual Regulated Revenues in Relevant Year t-1")

MAR_{t-1} Të hyrat e lejuara maksimale siç përcaktohen në vitin relevant t-1 ("Maximum Allowed Revenues as determined in Relevant Year t-1")

I_t Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga rregullatori gjatë azhurnimeve vjetore që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra



SHTOJCA 2 BAZA E ASETEVE TË RREGULLUARA

- 1 Kjo shtojcë përshkruan përcaktimin e bazës së asetëve të rregulluara për qëllime të llogaritjes së zhvlerësimit të lejuar .
- 2 Baza e asetëve të rregulluara do të jetë vlerë rregullative e shumës së asetëve fikse të përdorura dhe të përdorshme të FPEE-së që janë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve standarde. Baza e asetëve të rregulluara do të ndahet për kategori të ndryshme të asetëve.
- 3 Rregullatori do ta përcaktojë vlerën fillestare të bazës së asetëve të rregulluara (më 1 prill 2012) para fillimit të vitit të parë relevant;
- 4 Baza e asetëve të rregulluara do të azhurnohet në çdo vit si më poshtë:
 - 4.1 Kostoja e lejuar e zhvlerësimit gjatë vitit të tanishëm relevant do të zbritet nga baza e asetëve të rregulluara dhe do të llogaritet në mënyrë lineare duke përdorur jetëgjatësinë ekonomike;
 - 4.2 Shitja e asetëve gjatë vitit të tanishëm relevant do të zbritet nga baza e asetëve të rregulluara, bazuar në vlerën e shitjes së tyre;
 - 4.3 Shpenzimet e lejuara kapitale gjatë vitit të tanishëm relevant do t'i shtohen bazës së asetëve të rregulluara nga data kur aset i vihet në shërbim dhe në koston e lejuar nga rregullatori gjatë azhurnimit më të fundit vjetor. Gjatë azhurnimeve vjetore i licencuari mund të kërkojë që kostoja e realizuar e investimit dhe jo e lejuara t'i shtohet bazës së rregulluar të asetëve. Rregullatori duhet ta pranojë kërkesën nëse i licencuari mund ta demonstrojë në mënyrë të qartë që ndryshimi në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara është si pasojë e faktorëve jashtë kontrollit të të licencuarit dhe që ai i ka bërë përpjekjet më të mëdha për të minimizuar rritjet e kostove. Rregullatori nuk do të bëjë reduktime retroaktive të të hyrave të fituara gjatë periudhës rregullative të tanishme (tashmë të përfunduar) për të marrë parasysh ndryshimet në mes të kostove të lejuara dhe atyre të realizuara. Rregullatori do të marrë parasysh kostot e realizuara gjatë azhurnimeve vjetore si masë për parashikimin e kostos së investimeve të ardhshme;
 - 4.4 Nëse një projekt kapital i aprovuar nga rregullatori në azhurnimin më të vonshëm vjetor në planin e aprovuar të investimit nuk silllet në shërbim gjatë azhurnimit aktual vjetor, kostoja e lejuar e tij nuk i shtohet bazës së asetëve të rregulluara gjatë azhurnimit pasues vjetor, dhe të gjitha të hyrat e përfituara nga projekti në periudhën e vitit relevant aktual (që kanë të bëjnë me përfshirjen e tij në bazën e asetëve të rregulluara dhe përcaktimin e ndërlidhur të të hyrave të lejuara maksimale) duhet të zbriten nga të hyrat në azhurnimin vjetor pasues;
 - 4.5 Kurdo që kostoja e mirëmbajtjes është apo ka qenë më herët e përfshirë në kostot e lejuara operative, nuk do të lejohet të kapitalizohet apo të përfshihet në bazën e asetëve të rregulluara; dhe



- 4.6 Baza e asetëve të rregulluara do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin përgjatë vitit të kaluar relevant, duke përdorur indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat si masë relevante.
- 5 Jetëgjatësia ekonomike e asetëve për kategori të ndryshme të asetëve do të përdoret për të llogaritur zhvlerësimin në bazën e asetëve të rregulluara. Jetëgjatësia ekonomike do të vlerësohet gjatë shqyrtimeve të vlerave hyrëse për të reflektuar jetëgjatësinë teknike të asetëve, përveç në rastet kur ekziston arsye e demonstrueshme në lidhje me atë se përse jetëgjatësia teknike e një asemi duhet të ndryshojë nga jetëgjatësia ekonomike e dobishme e asetit.
- 6 Shpenzimet kapitale të lejuara do të përcaktohen gjatë azhurnimeve vjetore bazuar në dokumentet e dorëzuara në rregullator nga i licencuari. Këto dokumente të dorëzuara duhet të kenë formën e një plani rotativ të aprovuar të investimit që duhet të azhurnohet çdo vit. Planin e aprovuar të investimit do të:
- 6.1 Përfshijë projektet kapitale të cilat nevojiten në mënyrë të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve standarde;
- 6.2 Identifikojë çdo projekt kapital të renditur sipas prioritetit;
- 6.3 Tregojë përfitimin nga çdo projekt kapital, duke iu referuar, kudo që është e nevojshme, përmbushjes së standardeve relevante për furnizim standard, siç mund të kërkohet nga licenca e FPEE; dhe
- 6.4 Zhvillohet duke përdorur një analizë të kostove të diskontuara dhe të përfitimeve të projekteve kapitale.
- 7 Projektet e aprovuara kapitale do të zbatohen si më poshtë:
- 7.1 FPEE do të përdoret të gjitha metodat e arsyeshme për të siguruar implementimin e projekteve të aprovuara kapitale në kohën dhe sipas orarit të aprovuar;
- 7.2 Nëse FPEE, për arsye jashtë kontrollit të tyre, dështon në implementimin e projekteve kapitale në pajtim me orarin e aprovuar, atëherë FPEE duhet ta njoftojë rregullatorin. FPEE duhet të japë arsye të detajuara për vonesën së bashku me orarin e ri;
- 7.3 FPEE mund të aplikojë në çdo kohë te rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital me ndonjë projekt tjetër kapital të aprovuar në rastet kur mund të dëshmohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot). Nëse rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet bazës së asetëve të rregulluara në azhurnimin e ardhshëm vjetor. Të hyrat e lejuara maksimale në vitin relevant nuk do të përshtaten; dhe
- 7.4 Nëse FPEE e zëvendëson një projekt kapital me një projekt alternativ para se të marrë aprovimin paraprak të rregullatorit, rregullatori do të marrë në shqyrtim nëse do ta



aprovojë zëvendësimin në azhurnimin e ardhshëm vjetor, por nuk është i detyruar ta bëjë këtë.



SHTOJCA 3 PROCESI I SHQYRTIMIT TË VLERAVE HYRËSE

- 1 Me qëllim të ngritjes së transparencës, rregullatori do të publikojë në faqen elektronike zyrtare të gjitha dokumentet e dorëzuara, komentet dhe dokumentet e tjera relevante të pranuar nga FPEE apo palët e tjera të interesit që kanë të bëjnë me shqyrtimin e vlerave hyrëse brenda një afati të arsyeshëm, pas pranimit të informatave të dorëzuara nga FPEE, duke mos përfshirë këtu informatat që rregullatori i konsideron komercialisht konfidenciale.
- 2 Rregullatori mund të iniciojë shqyrtimin e vlerave hyrëse kurdo që i duket e arsyeshme. Nëse iniciohet shqyrtimi i vlerave hyrëse ai duhet të fillojë jo më vonë se 120 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. Një orar tjetër do të aplikohet gjatë periudhës kalimtare, siç specifikohet në Shtojcën 8.
- 3 Orari për procesin e përgjithshëm të shqyrtimit do të dërgohet te FPEE-ja gjatë inicimit të procesit të shqyrtimit.
- 4 Rregullatori do të iniciojë shqyrtimin e vlerave hyrëse duke njoftuar FPEE-në lidhur me:
 - 4.1 Vitet për të cilat kërkohen të dhënat për vitin aktual dhe parashikimet për të ardhmen;
 - 4.2 Formatin me anë të të cilit këto të dhëna do të dorëzohen;
 - 4.3 Orarin për dorëzimin e propozimit të FPEE-së për shqyrtimin e vlerave hyrëse.
- 5 Propozimi i FPEE-së do të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe do të adresojë çështjet në vijim (pa kufizim):
 - 5.1 Të hyrat e realizuara të rregulluara që janë fituar nga tarifa e rregulluar me pakicë gjatë vitit relevant (duke përdorur një vlerësim të arsyeshëm për muajt e mbetur kur është e nevojshme);
 - 5.2 Koston e realizuar për ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar gjatë vitit relevant, në linjë me përkufizimin e kostos që është përdorur për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale;
 - 5.3 Raportin vjetor dhe pasqyrat financiare të audituara për secilin vit fiskal që ka përfunduar në vitin relevant aktual, kur këto janë në dispozicion sipas kritereve për raportim të cilat i përmban licenca e FPEE-së;
 - 5.4 Sasinë e konsumit të energjisë elektrike të realizuar gjatë periudhës më të vonshme 12-mujore;
 - 5.5 Parashikimin e konsumit të energjisë elektrike për vitin relevant;



- 5.6 Numrin e konsumatorëve të rregulluar dhe të parregulluar për vitin e tanishëm relevant;
 - 5.7 Numrin e parashikuar të konsumatorëve të rregulluar dhe të parregulluar për vitin e ardhshëm relevant;
 - 5.8 Të hyrat e lejuara maksimale të parashikuara, duke raportuar ndaras për secilën prej komponentëve të kostos së lejuar, për vitin e ardhshëm relevant;
 - 5.9 Përcaktuesit aktualë të faturimit për periudhën më të vonshme 12-mujore si dhe përcaktuesit e parashikuar të faturimit për vitin e ardhshëm relevant, bazuar në parashikimet lidhur me kërkesën, energjinë dhe numrin e konsumatorëve për secilën kategori të tyre;
 - 5.10 Vlerat hyrëse të propozuara për vitin e ardhshëm relevant;
 - 5.11 Çdo studim të realizuar nga FPEE-ja që ka të bëjë me ndonjërin prej çështjeve të ngritura në propozimin e FPEE-së; dhe
 - 5.12 Çdo material tjetër shtesë që rregullatori konsideron se duhet të përfshihet në propozimin e FPEE-së, për sa kohë që rregullatori ta njoftojë FPEE-në me një kohë të arsyeshme para kalimit të afatit për dorëzimin e propozimit të FPEE-së.
- 6 Gjatë përgatitjes së propozimit të saj, FPEE do të zbatojë plotësisht parimet e kësaj rregulle. FPEE do të deklarojë të gjitha vendet ku nuk janë zbatuar këto parime, arsyet për moszbatimin e tyre, arsyet që përkrahin qasjen alternative dhe vlerësimin e ndikimit të përdorimit të kësaj qasjeje.
- 7 Pas marrjes së propozimit të FPEE-së, Rregullatori do të vlerësojë saktësinë, lidhshmërinë dhe arsyeshmërinë, duke përfshirë përcaktimin nëse:
- 7.1 Propozimi për vlerat hyrëse reflekton kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar; dhe
 - 7.2 Propozimi për tarifën e rregulluar me pakicë reflekton balancim të drejtë në mes të interesave të FPEE-së dhe atyre të konsumatorëve të rregulluar.
- 8 Rregullatori do të përgatisë një vlerësim të përkohshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj shtojce), para fillimit të vitit të ardhshëm relevant pas shqyrtimit të aplikacionit të FPEE-së dhe pas konsultimit me FPEE-në. Vlerësimi i përkohshëm do të paraqesë propozimet e rregullatorit për vlerat hyrëse dhe arsyeshmërinë për këtë propozim. Rregullatori gjatë përgatitjes së vlerësimit të përkohshëm mund të amendamentojë, të ndryshojë apo të fshijë cilëndo pjesë të propozimit të FPEE-së sipas vlerësimit të tij në rastet kur rregullatori ofron arsyeshmërinë për këto amendamente, zhvendosje apo fshirje.



- 9 Pas përcaktimit të vlerësimit të përkohshëm, rregullatori do të njoftojë FPEE-në dhe do të fillojë procesin e konsultimit publik mbi vlerësimin e përkohshëm në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 10 Pas përfundimit të konsultimit publik, brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj shtojce), para fillimit të vitit të ardhshëm relevant, rregullatori do të marrë vendim për vlerat hyrëse. Ky vendim do të jenë në pajtueshmëri me këtë rregull. Orari alternativ do të aplikohet gjatë periudhës kalimtare siç jepet në Shtojcën 8.
- 11 FPEE mund të apelojë apo kontestojë vendimin e rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.



SHTOJCA 4 PROCESI I AZHURNIMEVE VJETORE

- 1 Procesi i azhurnimeve vjetore për FPEE-në do të përbëhet nga tri faza:
 - 1.1 Faza 1: Përcaktimi i kostove të importit.
 - 1.2 Faza 2: Përcaktimi i kostove me pakicë.
 - 1.3 Faza 3: Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifës së rregulluar me pakicë.
- 2 **Faza 1: Përcaktimi i kostove të importit**
 - 2.1 FPEE do të dorëzojë propozimin për kostot e importit që do të përfshihet në llogaritjen e kostos së energjisë me shumicë për vitin e ardhshëm relevant, së paku 80 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. FPEE do të përfshijë po ashtu të gjitha të dhënat dhe dëshmitë relevante.
 - 2.2 Rregullatori do ta njoftojë FPEE-në së paku 60 ditë pune para fillimit të Vitit të ardhshëm relevant, nëse i aprovon ose jo, kostot e Importit të propozuara nga FPEE-ja.
 - 2.3 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për kostot e importit, atëherë rregullatori duhet të ofrojë një vlerë alternative për kostot e importit që duhet të përfshihen në llogaritjen e kostove të energjisë për vitin e ardhshëm relevant. Arsyetimi dhe dëshmitë për vlerën alternative do të sigurohen në pajtim me këtë rregull.
- 3 **Faza 2: Përcaktimi i kostove me pakicë**
 - 3.1 FPEE do të dorëzojë propozimin për kostot me pakicë që duhet të përfshihen në llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale për vitin e ardhshëm relevant së paku 50 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. FPEE duhet të përfshijë po ashtu të gjitha të dhënat dhe dëshmitë përkatëse.
 - 3.2 Rregullatori do ta njoftojë FPEE-në së paku 40 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant, nëse i aprovon ose jo, kostot me pakicë të propozuara nga FPEE-ja.
 - 3.3 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për kostot me pakicë, atëherë rregullatori duhet të ofrojë një vlerë alternative për kostot me pakicë që duhet të përfshihen në llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale për vitin e ardhshëm relevant. Arsyetimi dhe dëshmitë për vlerën alternative do të sigurohen në pajtim me këtë rregull.
- 4 **Faza 3: Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifës së rregulluar me pakicë**
 - 4.1 FPEE do të dorëzojë te rregullatori propozimin për të hyrat e lejuara maksimale dhe përshtatjen e nevojshme për tarifën e rregulluar me pakicë për vitin e ardhshëm relevant së paku 20 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. FPEE po ashtu



do të përfshijë në këtë dorëzim edhe dokumentet relevante dhe evidencën, përfshirë vlerat që kanë të bëjnë me të gjithë komponentët e formulave të azhurnimit vjetor të dhëna në Shtojcën 1 si dhe çdo informatë tjetër të kërkuar nga rregullatori.

- 4.2 Rregullatori në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojë nga FPEE që të japë sqarime shtesë për metodën e tij të llogaritjes së propozimit për të hyrat e lejuara maksimale apo të tarifës së rregulluar me pakicë dhe, nëse kjo kërkohet, FPEE duhet të ofrojë, brenda një periudhe të shpejtë kohore, çdo informatë apo shpjegim të mëtjshëm që kërkohet nga rregullatori.
- 4.3 Rregullatori do ta informojë FPEE-në para fillimit të vitit të ardhshëm relevant nëse e aprovon llogaritjen e FPEE-së për të hyrat e lejuara maksimale dhe për tarifën e rregulluar me pakicë.
- 4.4 Nëse rregullatori e aprovon propozimin për të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifën e rregulluar me pakicë, atëherë këto do të jenë të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifa e rregulluar me pakicë për vitin e ardhshëm relevant.
- 4.5 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifën e rregulluar me pakicë, rregullatori do të japë arsyetim dhe evidencë për këtë, në pajtim me këtë rregull. Tarifa e rregulluar me pakicë nuk do të ndryshojë derisa rregullatori të aprovojë një propozim alternativ ose të japë llogaritjen e tij për të hyrat e lejuara maksimale dhe përshtatjen përkatëse të tarifës së rregulluar me pakicë.
- 4.6 Çdo ndryshim në të hyra që mund të rezultojë nga llogaritjet e gabuara, raportimi i gabuar i të hyrave të realizuara të rregulluara apo kontestimet lidhur me azhurnimet vjetore, do të mbulohen në vitet relevante pasuese.
- 4.7 FPEE-ja mund të apelojë apo kontestojë çdo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.



SHTOJCA 5 PROCESI I SHQYRTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM

- 1 Nëse ka ndodhur një ngjarje e jashtëzakonshme, FPEE-ja mund të kërkojë shqyrtim të jashtëzakonshëm.
- 2 Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm nuk mund të fillojë brenda tre muajsh të shqyrtimit të vlerave hyrëse apo përfundimit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm të mëhershëm.
- 3 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm mund të ketë lidhje me më shumë se një ngjarje të jashtëzakonshme. Në këto raste, kjo shtojcë adreson ndikimin e përbashkët financiar të këtyre ngjarjeve.
- 4 Brenda 20 ditëve të punës pas kërkesës së FPEE-së për shqyrtim të jashtëzakonshëm, FPEE duhet të dorëzojë raportin për ndikimin financiar që do të përfshijë çështjet në vijim:
 - 4.1 Përshkrimin e ngjarjes së jashtëzakonshme që ka qenë shkak i kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm;
 - 4.2 Përmbledhjen e ndikimit të ngjarjes së jashtëzakonshme në veprimtarinë e FPEE-së;
 - 4.3 Vlerësimin e ndryshimeve në kostot e FPEE-së të ofrimit të shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar në secilin vit nga data kur ka ndodhur (apo filluar) ngjarja e jashtëzakonshme deri në përfundimin e vitit aktual relevant;
 - 4.4 Vlerësimin e ndryshimeve në të hyrat e parashikuara nga tarifa e rregulluar me pakicë që rezultojnë nga ngjarja e jashtëzakonshme në secilin vit nga data kur ka ndodhur (apo filluar) ngjarja e jashtëzakonshme deri në përfundimin e vitit aktual relevant;
 - 4.5 Llogaritjen e ndikimit financiar nga ngjarja e jashtëzakonshme në FPEE, e llogaritur si shuma e ndryshimeve në kostot dhe të hyrat e mësipërme të FPEE-së. Të hyrat do të trajtohen si numra pozitivë dhe kostot do të trajtohen si numra negativë; dhe
 - 4.6 Llogaritjen në lidhje me atë nëse ndikimi financiar pritet të jetë më i lartë se pragu i materialitetit, shumëzuar me të Hyrat që FPEE ka marrë (në vitin para ngjarjes së jashtëzakonshme), shumëzuar me përqindjen e vitit relevant që mbetet në mes të datës së ngjarjes së jashtëzakonshme dhe përfundimit të vitit relevant.
- 5 Nëse FPEE përcakton se ndikimi financiar është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë do të përfshijë në raportin e saj të ndikimit financiar propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme të të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifës së rregulluar me pakicë. Propozimi për përshtatjen e jashtëzakonshme duhet të pëmbushë këto kushte:
 - 5.1 Përshtatja e jashtëzakonshme duhet të ndryshojë të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifën e rregulluar me pakicë, në atë mënyrë që ndryshimi i parashikuar të jetë i barabartë me ndikimin financiar të ngjarjes së jashtëzakonshme;



- 5.2 Tarifa e re e rregulluar me pakicë duhet të jetë në përputhje me metodologjinë për strukturën tarifore dhe, kurdo që është e mundur, të jetë në përputhje me strukturën tarifore që ka ekzistuar para ndodhjes së ngjarjes së jashtëzakonshme; dhe
 - 5.3 Kohëzgjatja dhe struktura e përshtatjes së jashtëzakonshme, ku është e mundur, duhet të reduktojnë rritjet e menjëhershme të tarifave për kategoritë e konsumatorëve (për shembull duke zbutur efektin e përshtatjes së jashtëzakonshme përgjatë disa vitesh).
- 6 Rregullatori mund gjithashtu të fillojë shqyrtimin e jashtëzakonshëm pa kërkesën e FPEE-së. Në këto raste, rregullatori do ta njoftojë FPEE-në dhe do të përfshijë një përshkrim të ngjarjes së jashtëzakonshme si dhe një përmbledhje të ndikimit të saj të pritshëm. Pastaj, FPEE do të përgatisë raportin e ndikimit financiar sipas procesit të përshkruar më lart.
 - 7 Rregullatori mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme sqarime shtesë për mënyrën e tij të llogaritjes së raportit të ndikimit financiar si dhe përshtatjes së jashtëzakonshme dhe, nëse kërkohet kjo, FPEE duhet t'i dërgojë rregullatorit, brenda një afati sa më të shkurtër kohor, informatat apo shpjegimet e mëtejshme të kërkuara.
 - 8 Brenda 20 ditëve të punës pas marrjes së raportit për ndikimin financiar, rregullatori do ta njoftojë FPEE-në nëse rregullatori e pranon apo jo propozimin e FPEE-së për përshtatjen e jashtëzakonshme. Rregullatori do ta aprovojë propozimin nëse:
 - 8.1 I plotëson kushtet e përshkruara më lart;
 - 8.2 Është llogaritur në mënyrë të saktë; dhe
 - 8.3 Merr parasysh të gjitha informatat materiale në dispozicion gjatë asaj kohe.
 - 9 Nëse rregullatori e aprovon propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme, Tarifa e re e rregulluar me pakicë do të hyjë në fuqi menjëherë.
 - 10 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme, rregullatori duhet të ofrojë arsyeshmërinë dhe evidencën për këtë, në pajtim me këtë rregull. Tarifa e rregulluar me pakicë nuk do të përshtatet derisa rregullatori do ta aprovojë një propozim.
 - 11 FPEE mund të apelojë apo kontestojë çdo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.



SHTOJCA 6 NGJARJET E JASHTËZAKONSHME

- 1 Ngjarje e jashtëzakonshme do të konsiderohet të jetë:
 - 1.1 Ndryshimi në shkallën tatimore të aplikueshme për FPEE-në që nuk do të mbulohet tërësisht përmes azhurnimeve vjetore;
 - 1.2 Çfarëdo ngjarje e forcës madhore (force majeure), e përkufizuar në Shtojcën 7;
 - 1.3 Çfarëdo ngjarje tjetër që përmbush të gjitha kushtet në vijim:
 - (i) Nuk ka qenë nën kontrollin e FPEE-së;
 - (ii) Nuk do të mbulohet tërësisht përmes azhurnimeve vjetore; dhe
 - (iii) Do t'i ndryshojë në masë të konsiderueshme të hyrat dhe/ose kostot e FPEE-së gjatë një periudhe 12-mujore, në atë masë që mund të vlerësohet e arsyeshme se mund të tejkalohet pragu i materialitetit (e sqaruar në Shtojcën 5).
- 2 Ndodhja e ngjarjes së jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të shkaktuar shqyrtimin e jashtëzakonshëm por, siç sqarohet në Shtojcën 5, ajo ngjarje duhet ta tejkalojë pragun e materialitetit në mënyrë që të përshtaten të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifa e rregulluar me pakicë.



SHTOJCA 7 NGJARJET E FORCËS MADHORE

- 1 Ngjarja e forcës madhore është ngjarje apo rrethanë e jashtëzakonshme që i përfshin të gjitha në vijim:
 - 1.1 Është jashtë kontrollit të FPEE-së;
 - 1.2 FPEE nuk ka mundur ta parandalojë atë;
 - 1.3 FPEE nuk ka mundur ta shmangë apo ta tejkalojë; dhe
 - 1.4 Shkaktari substancial i saj nuk është FPEE.

- 2 Një ngjarje e forcës madhore mund të përfshijë, por nuk kufizohet në ngjarjet apo rrethanat e jashtëzakonshme të natyrës së paraqitur më poshtë, atëherë kur përmbushen kushtet e lartpërmendura:
 - 2.1 Luftë, gjendje lufte apo veprime ushtarake (pavarësisht a është shpallur luftë apo jo), pushtim, akt i armiqve të jashtëm;
 - 2.2 Rebelim, terrorizëm, sabotim nga persona që nuk janë punonjës të FPEE-së, kontraktues apo nënkontraktues, revolucion, kryengritje, pushtet ushtarak apo uzurpim, apo luftë civile;
 - 2.3 Protestë, trazirë, rrëmujë, grevë apo bllokim pune nga persona që nuk janë punonjës, kontraktues apo nënkontraktues të palës;
 - 2.4 Municione të luftës, materiale shpërthyesë, rrezatim jonizues apo kontaminim me radioaktivitet, përveç kur pala mund të ketë përdorur këto municione, lëndë shpërthyesë rrezatim apo radioaktivitet; dhe
 - 2.5 Katastrofat natyrore si tërmetet apo vërshimet.



SHTOJCA 8 PERIUDHA KALIMTARE

- 1 Periudha Kalimtare do të jetë prej 1 prill 2012 deri më 31 mars 2015.
- 2 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë do të llogariten gjatë periudhës kalimtare si më poshtë:
 - 2.1 Kostot totale të energjisë me shumicë të FPEE-së duhet të alokohen në mes të konsumatorëve të rregulluar dhe konsumatorëve të parregulluar në mënyrë të barabartë mbi bazë të konsumit, përveç nëse ekziston obligimi në një entitet tjetër të veçantë nga FPEE-ja, që të importojë energji për furnizimin e konsumatorëve të pakualifikuar, siç kërkohet në Ligjin për Energjinë elektrike. Në këto raste, kostot e importimit nga entiteti që e bart këtë obligim, siç ngarkohet FPEE, do të barten tërësisht mbi konsumatorët e pakualifikuar.
- 3 Në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e energjisë, ndër-subvencionimet në mes të kategorive të konsumatorëve do të lejohen gjatë periudhës kalimtare si më poshtë:
 - 3.1 Në rastet kur ekzistojnë shtrembërime të konsiderueshme historike të çmimeve, tarifa e rregulluar me pakicë mund të përfshijë ndër-subvencionime në mes të kategorive të konsumatorëve;
 - 3.2 Ndër-subvencionimet do të ribalancohen gradualisht deri më 31 dhjetor 2014, prej së cilës datë e tutje nuk do të ketë ndër-subvencionime; dhe
 - 3.3 Për qëllime të rebalancimit gjatë periudhës kalimtare, struktura e tarifës së rregulluar me pakicë mund të ndryshojë brenda viteve relevante. Ndryshimet do të përkufizohen nga rregullatori gjatë shqyrtimeve të vlerave hyrëse në një mënyrë që do të zbusë rebalancimin. Ndryshimet në strukturën tarifore do të zbatohen në të njëjtën kohë me azhurnimet vjetore.
- 4 Gjatë shqyrtimit të parë të vlerave hyrëse dhe azhurnimit vjetor do të vlejë orari në vijim:
 - 4.1 Rregullatori do ta iniciojë shqyrtimin e vlerave hyrëse jo më vonë se 60 ditë pune para fillimit të vitit të parë relevant të periudhës kalimtare.
 - 4.2 Rregullatori do ta përgatisë vlerësimin e përkohshëm jo më vonë se 45 ditë pune para fillimit të vitit të parë relevant të periudhës kalimtare.
 - 4.3 Rregullatori do ta marrë vendimin e tij përfundimtar për vlerat hyrëse jo më vonë se 30 ditë pune para fillimit të vitit të parë relevant të periudhës kalimtare.
 - 4.4 FPEE-ja duhet të dorëzojë aplikacionin me propozimin e saj për kostot me pakicë, të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifën e rregulluar me pakicë në të njëjtën kohë, jo më vonë se 25 ditë pune para fillimit të vitit të parë relevant të periudhës kalimtare.
 - 4.5 Rregullatori do ta marrë vendimin e tij përfundimtar para fillimit të vitit të parë relevant të periudhës kalimtare.